



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Ministria e Financave – Ministarstvo za Finansije – Vlada-Government**  
**Ministry of Finance**  
**AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT**  
**CENTRALNA AGENCIJA NABAVKE**  
**CENTRAL PROCUREMENT AGENCY**

Agjencioni Qendror i Prokurimit, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Ligji Nr. 03/ L -149, neni 12, paragrafi 4, si dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit neni 18 procedur e shkurtër, bën:

**Shpallje e Konkursit Publik**  
**për Marveshje per Sherbime te Vecanta**

**Institucioni:** Agjencioni Qendror i Prokurimit  
**Titulli i vendit të punës:** Zyrtar i/e Prokurimit  
**Paga mujore:** 437.50 euro bruto  
**Numri i zyrtarëve :** Një (1) pozitë  
**Orët e punës në javë:** 40  
**Kohëzgjatja e kontratës:** Gjashte (6) muaj  
**Data e Shpalljes:** 23.03.2017  
**Vendi:** Prishtinë

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Harton dosjen e tenderit dhe dokumentacionit tjetër të nevojshëm, për procedurat e prokurimit me vlera te vogla dhe vlera minimale për furnizim, shërbim dhe pune,
- Bënë përgatitjen e hapjes publike të ofertave dhe përpilimin e procesverbaleve te hapjes se ofertave
- Merr pjesë në komisionet e hapjes dhe vlerësimit të ofertave;
- Siguron trajtim të barabarta dhe konkurrencë për të gjithë ofertuesit ;
- Siguron që të gjitha kërkesat për te cilat i zhvillon aktivitetet e prokurimit janë te nënshkuara nga personat e autorizuar;
- Përgatitë raporte javore, mujore dhe vjetore mbi aktivitetet e prokurimit te cilat i kryen;

- Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së Shefes se Sektorit për Prokurime ne emër te Autoriteteve Kontraktuese.

**Kualifikimi, Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen:**

- Diplomë apo Certificate universitare ne ekonomi ose juridik .
- Njohja e punës me kompjuter në programet Word , Excel, përdorimin e internetit dhe Data bazës;
- Aftësi komunikuese dhe aftësi për pune ekipore

**Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:** Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e kërkuar dhe aftësinë profesionale.

**Lloji i kontratës: “ Marrëveshje për shërbime të veçanta”**

**Data e fillimit te marrëveshjes : 01.04.2017**

**Data e perfondimit te marreveshjes : 30.09.2017**

**Dorëzimi i kerkesave per aplikim:**

Aplikacioni merret dhe dorezohet se bashku me dokumentat identifikues dhe deshmitet e pergatitjes profesionale në Zyrën e Personelit, ish-Ndërtesa e Germis, Kati i- V-A501.

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni Zyrën e Personelit në numrin e Tel. 038/0200-15-511, prej orës 08:00 – 16:00, apo të shkruani në e-mail: [ardiana.hajdari@rks-gov.net](mailto:ardiana.hajdari@rks-gov.net).

Shpallja mbetet e hapur 5 ditë kalendarike nga data: e publikimit në Web faqen e Agjencionit Qendror të Prokurimit [www.aqp@rks-gov.net](mailto:www.aqp@rks-gov.net), duke filluar nga data: **23.03.2017** deri më datën: **27.03.2017** ora 16:00.

Kërkesat e dërguara pas afatit nuk do të pranohen si dhe ato të pakompletuara do të refuzohen. Kandidatet te cilet hyn ne listen e ngushtë per intervistim ,do te kontaktohen përmes telefoni.